



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; Dhe

KONZORCIUMI "Guri Group" Shpk & "GURI" Shpk, Komuna e Istogut, të cilat i përfaqëson z.nja Fatjona Bicaj emaj, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810076358 perkatesisht, 810296310 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

HAPJA E RRUGËS MALORE SUDENICË – LUGU I MAHALLËS– Lot 2

| | |
|-------------------------|--|
| Nr. I prokurimit | 633-20-5023 -5-2-1/ C 375 LOT 2 |
| Nr. I brendshëm | 633 / 020 / 079/ 521 – LOT 2 |

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

HAPJA E RRUGËS MALORE SUDENICË – LUGU I MAHALLËS– Lot 2

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **HAPJA E RRUGËS MALORE SUDENICË – LUGU I MAHALLËS– Lot 2**

është: 35.840,00 € dhe me fjalë:

/Tridhjetëepesëmijëetëçindekatërdhjetëzerozero €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjes së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet në afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 15.12.. 2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet në afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
"Guri Group" & "Guri" Shpk

| | | | |
|--------------------|---|--------------------|---|
| Emri: | Gëzim Ademaj | Emri: | Fatjona Bicaj |
| Pozita: | U.D. Menaxheri-t të Prokurimit | Pozita: | Lider i grupit |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 20. 10. 2020 | Data: | 20.10.2020 |
| Vu la |  | Vu la |  |

Numri i Prokurimit: 633/20/079/521– Titulli LOTO 1-MIREMBAJTJA E RRUGEVE MALORE, LOTO2-HAPJA E RRUGES MALORE STUDENICE-LUGU I MOHALLES, LOTO 3-RREGULLIMI I LEKENEVE PER UJI NE BJESHKET E KALIQANIT, LOTO 4-HAPJA E RRUGES MALORE POLANE-OSHLAK,dhe LOTO 5-HAPJA E RRUGES MALORE LUGU I MEHAJVE-STANET E LUBOVES

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentim/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë:GJUHA SHQIPE. |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 30DITE ME GJATE SE PERFUNDIMI I KONTRATES.</i> |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite. |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë 5 dite nga nënshkrimi i kontrates |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë:60 ditë. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25%</i> për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i> |
| Parapagimi | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: ska |
| Zgjidhja miqësore e | 42.2 | Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet |

Numri i Prokurimit: 633/20/079/521– Titulli LOTO 1-MIREMBAJTJA E RRUGEVE MALORE, LOTO2-HAPJA E RRUGES MALORE STUDENICE-LUGU I MOHALLES, LOTO 3-RREGULLIMI I LEKENEVE PER UJI NE BJESHKET E KALIQANIT, LOTO 4-HAPJA E RRUGES MALORE POLANE-OSHLAK,dhe LOTO 5-HAPJA E RRUGES MALORE LUGU I MEHAJVE-STANET E LUBOVES

| | | |
|--|------|---|
| mosmarrëveshjeve | | ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë |

**Paramasa për ndërtimin e rrugës:
"Studenicë-Lugu i Mahallës" Komuna e Istogut**

Gjatësija L=5000m Gjërsia 5.0 m

| Nr. | Pozicioni | Njësia | Sasia | Çmimi njësi | Çmimi total |
|---|--|----------------|-----------|----------------|------------------|
| | | | | € | € |
| 1 INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN | | | | | |
| 1.1 | Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit, si dhe punimi i projektit të ekzekutuar në tri kopje fizike dhe tri kopje elektronike-CD. | m' | 5,000.00 | 1.00 | 5,000.00 |
| Gjithsej 1: | | | | | 5,000.00 |
| 2 PASTRIMI I TERENIT | | | | | |
| 2.1 | Prejra e drunjeve dhe shkurreve (me nxjerrje të cungave dhe rrenjeve në dy anët e trupit të rrugës): Ø10-Ø40cm, me bartje në deponi në largësi min. 5 km. | m' | 5,000.00 | 1.00 | 5,000.00 |
| Gjithsej 2: | | | | | 5,000.00 |
| 3 PUNËT TOKËSORE | | | | | |
| 3.1 | Gërmimi i dheut i kategorisë së V- VI-të (formacion I fortë) me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 5km | m ³ | 63,000.00 | 0.20 | 12,600.00 |
| 3.2 | Gërmimi i dheut i kategorisë së III- IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 10km | m ³ | 2,500.00 | 1.00 | 2,500.00 |
| 3.3 | Gërmimi i formacionit shkëmbor, në vende të caktuara edhe me cekën, të sipërfaqes në mënyrë që të krijohet zgjerimi i rrugës ashtu siç është parapar në projektë. | m ³ | 1,000.00 | 1.00 | 1,000.00 |
| 3.4 | Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri 30MN/m ² | m ² | 35,000.00 | 0.10 | 3,500.00 |
| 3.5 | Hapja e kanaleve anësore për largimin e ujrave atmosferike. | m' | 14,000.00 | 0.10 | 1,400.00 |
| Gjithsej 3: | | | | | 21,000.00 |

1 INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN

4 OBJEKTET

| Lëshesat gypore, dhe muret prej guri | | | | | |
|---|--|----------------|-----------|-------|-----------------|
| 4.1 | Punimi i mbushjes me material te nxjerrur nga germimi I rrugës(40MN/m2) me CBR>15%. | m ³ | 26,000.00 | 0.10 | 2,600.00 |
| 4.2 | Punimi i lëshesëve gypore me : Furnizimi ,bartja dhe montim te gypave te armuar nga betoni te vendosur ne shtrese tamponi me punim te bredhit ,kokave te lëshesave ose parapeteve me C-25/30 dhe kalldermes me gure te vendosur ne shtres prej rere me mbushje te fugave me llaq cimentoje. | | | | |
| | Ø800 | m' | 60.00 | 10.00 | 600.00 |
| | Ø1000 | m' | 30.00 | 20.00 | 600.00 |
| | Ø1200 | m' | 24.00 | 20.00 | 480.00 |
| 4.3 | Punimi i mureve rezistuese nga guri me llaq qimentoje 1:3:6 dhe me aditiv me trashësi t=80 cm. | m ³ | 50.00 | 10.00 | 500.00 |
| 4.4 | Furnizimi dhe vendosja e pahive metalike elastike te njënjefishta- skaji I epërm I debuesit duhe të jetë 0.75 m mbi nivelin e trasës së rrugës. - debuesi duhet të jetë I larguar nga skaji I trasës për jo më pak se 0.5 m, - distanca mes mbajtësve duhet të jetë - më e vogël se 2 m për një prerje të hapur, Në këtë pozicion duhet te llogaritet edhe hapja e vrimes ne formacion te forte te tokës, per ankerimin e shtylles së pahis elastike. | m' | 60.00 | 1.00 | 60.00 |
| Gjithsej 4: | | | | | 4,840.00 |

REKAPITULLIMI

| | |
|---|------------------|
| 1 INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN | 5,000.00 |
| 2 PASTRIMI I TERENIT | 5,000.00 |
| 3 PUNËT TOKËSORE | 21,000.00 |
| 4 OBJEKTET | 4,840.00 |
| TOTALI: | 35,840.00 |

